



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. ...958..., date 6.5.2009

PER

MIRATIMIN E KATEGORIVE TE LICENCIMIT DHE PROCEDURAVE TE
APLIKIMIT PER LICENCE TE OPERATOREVE QE USHTROJNE
VEPRIMTARINE NE SISTEMET E FURNIZIMIT ME UJE, TE LARGIMIT
DHE TRAJTIMIT TE UJRAVE TE NDOTURA

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe neneve 2,15,16,17 te ligjit Nr. 8102, dt. 28.03.1996 "Per Kuadrin Rregullator te furnizimit me uje dhe te largimit e trajtimit te ujrave te ndotura", te ndryshuar dhe ligjit Nr.10081 date 23.2.2009 " Per licencat, autorizimetdhe lejet ne Republiken e Shqiperise, me propozimin e Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit, Keshilli i Ministrave:

VENDOSI:

- I. Miratimin e kategorive te licencave per personat fizike dhe juridik qe ushtrojne apo do te ushtrojne veprimtarine e tyre ne menaxhimin e sistemeve te furnizimit me uje dhe te largimit e perpunimit te ujrave te ndotura, si me poshte vijon:
 - a) Kategoria A, per grumbullimin dhe shperndarjen e ujit per konsum publik
 - b) Kategoria B, per perpunimin e ujit per konsum publik
 - c) Kategoria C, per largimin e ujrave te ndotura
 - d) Kategoria D, per perpunimin e ujrave te ndotura

II. Personat, fizik apo juridik, per tu pajisur me license per ushtrimin e veprimtarise ne sistemet e furnizimit me uje dhe te largimit e perpunimit te ujrave te ndotura duhet te dorezojne, prane ERRU-se. dokumentet e meposhtme:

1. Kerkese me shkrim per aplikim per licence, sipas formes se kerkuar nga ERRU-ja .
2. Dokumentin e regjistrimit ligjor te operatorit, si person fizik apo juridik ne Qendren Kombetare te Regjistrimit;
3. Autorizimin nga pronari per drejtuesin ligjor, i cili i jep te drejten per te kryer te gjitha veprimtarite per aplikimin dhe perdorimin e licenses perkatese;
4. Dokumentin e regjistrimit ne organet tatimore te zones administrative, ku kerkohet te kryhet sherbimi;
5. Lejen higjeno – sanitare nga Inspektoriati Sanitar Shteteror i zones administrative, ku kerkohet te kryhet sherbimi;
6. CV e drejtuesit ligjor dhe teknik.
7. Lejen e mjedisit, kur kerkohet license per perpunimin e ujrave te ndotura;
8. Dokumentat e kualifikimit te drejtuesit teknik si me poshte vijon:

a) Per sistemet e furnizimit me uje dhe largimit te ujrave te ndotura, Drejtuesi teknik duhet te kete diplome universitare ne deget e inxhinierise hidroteknike, ndertim,inxhinjeri elektrike, mekanike, mjedis apo disiplina te ngjashme si dhe nje pervoje pune mbi 5 vjet ne kete sektor.

b) Ne rastet kur operatori do te ushtroje veprimtarine per perpunimin e ujrave per konsum publik apo per perpunimin e ujrave te ndotura, ai duhet te kete edhe nje drejtues teknik te kualifikuar me diplome universitare, ne deget e inxhinierise hidroteknike, mjedisit,inxhinjeri elektrike, mekanike, kimike, mikrobiologjike apo disiplina te tjera te ngjashme.

9. Dëshmitë e penaltetit për drejtuesin ligjor dhe teknik.
10. Deklaratën me shkrim e drejtuesit ligjor dhe atij teknik, ku të deklarojë me përgjegjësi zbatimin e akteve ligjore dhe nenligjore të nxjerra nga ERRU-ja, të standartet shqiptare për veprimin dhe mirëmbajtjen e sistemit e të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Procesi i sigurimit të dokumentacionit të mesipër nga ERRU-ja zgjat jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e aplikimit për licencë nga subjekti përkatës.

- III. Ngarkohet Komisioni Kombëtar i ERRU për zbatimin e këtij Vendimi.
- IV. Vendimi nr.400, datë 19.08.1999, i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletorën zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

PROF.DR. SALI BERISHA